



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1604 Prot

Tiranë, më 14 /10/2019

REKOMANDIM

Nr. 44 , datë 14 /10 /2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK "INSTITUTI I STATISTIKAVE "

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

1. Në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare <http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%3%abrko-t%3%abdh%3%abna/programi-i-transparenc%3%abs/>, të Autoritetit Publik "Instituti i Statistikave " (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të programit të transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “Publikimet”, në të cilën programi i transparencës shfaqet si një nën menu.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pasqyruar në mënyrë jo të plotë në programin e transparencës.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo Autoriteti Publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gjerat:

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

f) informacion për shërbimet që Autoriteti Publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara në rubrika të tjera të faqes por, nuk janë të ndërlidhura me tabelën e programit (të pa linkuar), ose citohet linku por është i pa aksesueshëm. Konkretisht si më poshtë:

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës (linku nuk ndërlidhet me informacionin e cituar);

ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit (linku nuk ndërlidhet me informacionin e cituar);

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga Autoriteti Publik.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet të përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Instituti i Statistikave , në zbatim të gërmave a), b), c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 14.10.2019

KOMISIONERI



Besnik Dervishi



Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Instituti i Statistikave (INSTAT)


1. **Instituti i Statistikave (INSTAT)** ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun: <http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%3%abrko-t%3%ab-dh%3%abna/programi-i-transparenc%3%abs/>

Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore (në fund) menu-në “Publikimet”, nën menu-në “Programi i transparencës”, rubrika “Programi i transparencës INSTAT” dhe programi i transparencës shfaqet në këtë rubrikë.



IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENÇËS NË INSTAT					
Kategori e informacionit publik po kërkohet	Baza ligjore	Dokument i Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Pastrimi i strukturës organizative, funksionet dhe detyrat në autoritetit publik	Neni 7/1/a/d	Organizimi Struktura Organizimi	Mospërbet për miratimin të aktit nga shërbimi.	Mënyra përkatëse në faqe zyrtare: http://instat.gov.al/al/ / http://web.insh.ch/struktura-organizative/	Drejtoria Financës dhe Shërbimeve
Akte ndërkombëtare ligje, akte të brendshme, dokumente politike, dokumente ligjore	Neni 7/1/b		Mospërbet për bërjen në fuqi të tyre	Mënyra përkatëse në faqe zyrtare: http://instat.gov.al/al/ / http://web.insh.ch/legjislative/	Sektori i Publikimeve
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c	Ligji "Për të Drejtën e Informimit" Forma: Kërkesë/Ankesë Adresë Postare Adresë email Platësim kërkesave për informim Kërkesë / ankesë: info@instat.gov.al		Mënyra përkatëse në faqe zyrtare: http://www.insh.ch/al/ / http://web.insh.ch/legjislative/ / http://instat.gov.al/al/ / http://web.insh.ch/kontaktimi/	Sektori i Publikimeve
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktin e koordinimit për të	Neni 7/1/g			Mënyra përkatëse në faqe zyrtare: http://instat.gov.al/al/ / http://web.insh.ch/kontaktimi/	

7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen kryesore dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**



7.1.b) tekstet e plotë: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen kryesore dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**

INSTAT
Instituti i Statistikave

95 VJET STATISTIKA ZYRTARE

English | Rregullorja | FAQ | Bënjësi Kërkimi

Kreu | Temat | Statistika | Publikime | Dokumentimi | SDGs | Rreth Nesh

Kërkim për statistika

Rreth Nesh | Legjislacioni

LEGJISLACIONI

Ligji për Statistikat Zyrtare
LIGJ NR. 177/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE
LIGJ NR. 9180, DATE 5.2.2004 PËR STATISTIKAT ZYRTARE

Programi për Statistikat Zyrtare
PROGRAMI KOMBËTAR I STATISTIKAVE ZYRTARE 2017-2021
PROGRAMI KOMBËTAR I STATISTIKAVE ZYRTARE 2012-2016
Vendimi nr. 40/2019 Për miratimin e Planit të Më 2019 për zbatimin e PSZ 2017 - 2021


Rezoluta
REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKËS PËR VITIN 2018

Vendimet
Vendimi nr. 670, datë 7.11.2018
Vendimi nr. 669, datë 7.11.2018
Vendimi nr. 671, datë 7.11.2018
Vendimi nr. 293, datë 19.6.2019

Rreth Nesh

- Ne jemi INSTAT
- Legjislacioni
- Antaret
- Vendit të lexojmë
- Kërko të dhëna
- INSTAT dhe bashkëpunimet
- Programet dhe Ankëndrit
- Cena i Popullsisë dhe Banskave 2020 në Shqipëri


7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. **Informacioni është i publikuar në menu-në “Publikimet”, nën menu-në “Programi i transparencës”, rubrika “Kërkesa për të dhëna” por nuk është i ndërlidhur me programin pasi kur klikon rezulton Gabim 404!**




7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit. **Informacioni është i publikuar në menu-në “Publikimet”, nën menu-në “Programi i transparencës”, rubrika “Koordinator për të drejtën e informimit” por nuk është i ndërlidhur me programin pasi kur klikon rezulton “Gabim 404!”.** Mungon orari i punës së koordinatorit për të drejtën e informimit.



7.1.d) një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime. **Informacioni gjendet i publikuar në menu-në “Program i Transparencës” dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**




7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. **Informacioni është i publikuar në menu-në “Publikimet”, nën menu-në “Programi i transparencës”, rubrika “Buxheti, raporte dhe auditimi” por nuk është i ndërlidhur me programin pasi kur klikon të referon faqen kryesore.**







7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni është publikuar pjesërisht në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës. Nuk është bërë përditësimi i buxhetit për vitin 2019.**




7.1.ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;- **Informacioni nuk është i publikuar në faqe pavarësisht se në programin e transparencës është ndërlidhur menu-ja “Procedura Prokurimi” dhe “Faqja Zyrtare: <https://www.app.gov.al/>” por kur klikon nuk rezulton asnjë informacion i publikuar. Në menu-në “Publikimet”, nën menu-në “Programi i transparencës”, rubrika “Buxheti, raporte dhe auditimi” është publikuar informacion mbi regjistrin e realizimeve të prokurimit publik për vitin 2017 (katër – mujori i parë).**






7.1.f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit - **Informacioni nuk është i publikuar në faqe pavarësisht se citohet në tabelën e programit model të transparencës se shërbimet për publikun kryen nëpërmjet adresës info@instat.gov.al si dhe kontakte direkte.**




7.1.g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. **Informacioni është i publikuar në menu-në “Publikimet”, nën menu-në “Programi i transparencës”, rubrika “Kërkesa për të dhëna” dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**



interstitial porphyrias

Programmi e Trasparenza



7.1.gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; - **Informacioni nuk është i publikuar në faqe pavarësisht se në tabelën e programit model të transparencës është ndërlidhur një link i cili nuk aksesohet.**



7.1.h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; - **Informacioni nuk është i publikuar në faqe;**

				http://www.instat.gov.al/infotsh-mesh/meshinstituti/ http://www.instat.gov.al/infotsh-mesh/meshinstituti/	
Paraqitja e mendimeve në lirinë e shtetërore (paktet, etj.)	Neni 7/3 (g)	Konsultimi me shtetërore dhe institucionet vendimtare në blogjet		http://www.konsultimipublik.gov.al/	
Mbrojtja e dokumentacionit nga INSTAT	Neni 7/3 (h)	Dokumentacioni origjinal			Zyra e Arkivës dhe Preskriptit
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas neni 8 të këtij ligji nr. 119/2014	Neni 7/3 (i)		Pas marrëveshjes së Programit të Transparencës	Marrëveshja përkatëse në ligji kryesor: http://www.instat.gov.al/infotsh-mesh/programi-të-transparencës/73%28A%28%29	Koordinatori

7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji - **Informacioni është i publikuar në menu-në “Publikimet”, nën menu-në “Programi i transparencës”, rubrika “Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve” dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës. Përditësimi i regjistrit datë 30.09.2019.**

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, në linkun e mëposhtëm mund të gjeni Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve për Menusorin e fundit


- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Shtator - Prill 2010
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Maj - Korrik 2010
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Gusht - Shtator 2010
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Tetor - Dhjetor 2010
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Janar - Mars 2011
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Prill - Qershor 2011
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Korrik - Shtator 2011
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Tetor - Dhjetor 2011
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Janar - Mars 2012
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Prill - Qershor 2012
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Korrik - Shtator 2012
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Tetor - Dhjetor 2012
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Janar - Mars 2013
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Prill - Qershor 2013
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Korrik - Shtator 2013
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Tetor - Dhjetor 2013
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Janar - Mars 2014
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Prill - Qershor 2014
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Korrik - Shtator 2014
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Tetor - Dhjetor 2014
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Janar - Mars 2015
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Prill - Qershor 2015
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Korrik - Shtator 2015
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Tetor - Dhjetor 2015
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Janar - Mars 2016
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Prill - Qershor 2016
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Korrik - Shtator 2016
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Tetor - Dhjetor 2016
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Janar - Mars 2017
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Prill - Qershor 2017
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Korrik - Shtator 2017
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Tetor - Dhjetor 2017
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Janar - Mars 2018
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Prill - Qershor 2018
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Korrik - Shtator 2018
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Tetor - Dhjetor 2018
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Janar - Mars 2019
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Prill - Qershor 2019
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Korrik - Shtator 2019
- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve, Tetor - Dhjetor 2019

Shpërndaj faqen:


Facebook Twitter LinkedIn YouTube


556 Paj 10/11/2019

7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh— **Informacioni është i publikuar në menu-në “Temat” dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**



7.1.1) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik – Përgjithësisht faqja zyrtare e autoritetit është e pasur me informacion, por **informacioni nuk është publikuar sipas formatit të programit model të transparencës**. (në tabelën e programit model të transparencës është ndërlidhur një link i cili nuk ka informacion “Gabim 404!”)





Autoriteti Publik	Instituti i Statistikave (INSTAT)
Programi i transparencës	Po
Koordinatori	Po
Regjistri i kërkesave	Po
7.1.aPërshkrim/struktura, funksionet dhe detyrat A.P	Po
7.1.b Tekst, e plotë të konventave, ligjeve, akteve	Po
7.1.c Procedura për kërkesë për informacion	Po
7.1.ç Të dhënat e vendodhjes së AP	Po
7.dTë dhënat për arsim, pagat	Po
7.1.dh Auditimi	Po
7.1.e Buxheti	Pjesërisht
7.ë Procedurat e Prokurimit	Pjesërisht
7.1.f Shërbimet e A.P	Po
7.1.g Procedura për ankesë për veprimtarinë e AP	Po
7.1.gj Mekanizma për dhënien e mendimeve	Jo
7.1.h Mbajtja e dok(Arkiva)	Jo
7.i Regjistri i kërkesave	Po
7.1.k Dokumente që kërkohen shpesh	Po
7.1.l Çdo Informacion i dobishëm	Pjesërisht